



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN

02 Nr. / Br. 471/21

Nr. i fq. / Br. st. _____

Data: / Datum 21.04.2021

VUSHTRRI - VUČITRN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 “g” të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Komisionit për Vlerësim të Dëmeve të Shkaktuara nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, për kompensim të dëmeve ekonomike familjare të cilave iu janë shkaktuar dëme materiale nga vërshimet e muajit janar 2021 në vendbanimet e përfshira në raportin përmbledhës të komisionit, gjithsejtë 136 raste. Vlera e tërësishme e kompensimit është 162,000 00 € (njëqindegjashtëdhjetëedymijë euro).
2. Kompensimi i dëmeve të bëhet në shkallën prej 31,27 % të vlerës së tërësishme të dëmit të shkaktuar për secilin rast.
3. Mjetet financiare në shumën e cekur në pikën 1 të këtij vendimi të paguhet nga buxheti i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, të cilat janë alokuar nga Ministria e Pushtetit Lokal si ndihmë nga vërshimet, për Komunën e Vushtrrisë.
4. Këto mjete do të iu paguhet secilës ekonomi familjare të përfshirë në raportin e komisionit vlerësues të dëmeve, që është pjesë e këtij vendimi, bashkëngjitur në shtojcë.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.




Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Me këtë vendim, caktohen zyrtarët kontaktues të komunës për raportim lidhur me performancën e komunës, në këtë përbërje:
 - 1.1 **Islam Latifi**, koordinator, (Drejtoria e Shërbimeve Publike),
 - 1.2 **Shqipe Gashi**, (Drejtoria e Shërbimeve Publike),
 - 1.3 **Mentor Jashari**, (Drejtoria e Shërbimeve Publike),
 - 1.4 **Bislim Dushi**, (Zyra e Personelit)
 - 1.5 **Arta Haxhaj**, (Drejtoria për Urbanizëm),
 - 1.6 **Enver Bajrami**, (Drejtoria për Arsim),
 - 1.7 **Abit Abiti**, (Drejtoria për buxhet),
 - 1.8 **Selim Pllana**, (Drejtoria për Ekonomi...)
 - 1.9 **Liridon Lahu**, (Drejtoria për Administratë),
 - 1.10 **Behram Rrahmani**, (Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim),
 - 1.11 **Egzon Haradinaj**, (Drejtoria për Inspektive),
 - 1.12 **Naim Ferizi**, (Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale),
 - 1.13 **Blerim Zhabari**, (Zyra për Informim),
 - 1.14 **Bujar Klinaku**, (Sekretaria e KK-së),
 - 1.15 **Remzije Zekolli**, (Njësia për Barazi Gjinore dhe të Drejtat e Njeriut),
 - 1.16 **Liridon Hajdini**, (Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport),
 - 1.17 **Besarta Muzaqi Feka**, (Zyra e Kryetarit),
 - 1.18 **Fisnik Kamberi**, (QKMF),
 - 1.19 **Xhafer Islami**, (Drejtoria e Prokurimit),
 - 1.20 **Përfaqësuesi i KRM "Uniteti"** – Njësia në Vushtrri,
 - 1.21 **Përfaqësuesi i KRU "Ujësjellësi"** – Njësia në Vushtrri.
2. Zyrtarët e cekur në pikën paraprake, secili nga fusha respektive do të mbledhë verifikoj dhe raportoje të dhënat e sakta te koordinatori, në bazë të sistemit të rishikuar të menaxhimit të performancës në fushat të cilat janë pjesë e këtij sistemi. Para fillimit të mbledhjes së të dhënave këta zyrtar do të marrin udhëzime nga koordinatori për mënyrën e mbledhjes verifikimit dhe raportimit, si dhe do të kërkojnë sqarime shtesë në rast të ndonjë paqartësie.
3. Të dhënat sipas pikës paraprake përfshijnë:

- 3.1 Të dhënat për disa shërbime që i ofron komuna për fusha të caktuara raportohen për periudhën kohore 6 mujore dhe 1 vjeçare.
- 3.2 Të dhënat për shërbimet tjera specifike që i ofron komuna kërkohet të raportohen në mënyrë kumulative.
4. Afati për dërgimin e të dhënave do të përcaktohet nga MAPL.
 5. Zyrtarët komunal nga pika 1 (një) e këtij vendimi do t'i kryejnë me kohë dhe përgjegjësi obligimet e përcaktuara me këtë vendim. Të dhënat e raportuara do të jenë pjesë e auditimit nga Zyra e Auditori i Përgjithshëm.
 6. Koordinatori komunal do t'i kryej të gjitha obligimet sipas Rregullores së MPL-së për sistemin e menaxhimit të performancës komunale dhe dokumenteve tjera relevante të lidhura me sistemin e rishikuar të menaxhimit të performancës komunale që kanë të bëjnë me procesin e mbledhjes, verifikimit dhe raportimit të të dhënave për sistemin e menaxhimit të performancës në komuna.
 7. Drejtorët komunal përkatësisht përgjegjësit sektorial kanë gjithashtu përgjegjësi për mbarëvajtje të procesit të raportimit brenda drejtorisë – sektorit, duke siguruar saktësinë e të dhënave për raportim.
 8. Drejtoria e administratës ka rol të veçantë në lehtësimin e komunikimit në mes të drejtorive dhe zyrtarëve komunal për raportim.
 9. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi 02nr. 1533/18, dt. 10.12.2018.
 10. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

 Xhafer Tahiri
Kryetar i Komunës

Vendimi ju dërgohet:

- Drejtorëve të drejtorive,
- Përgjegjësve sektorial,
- Zyrtarëve nga pika 1 (një) e këtij vendimi dhe
- Arkivit të Sekretarisë.

REPublika e Kosovës - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN

02 Nr. / Dr. 478/21

Nr. i fq. / Br. sh.

Data: / Datum 23.04.2021

VUSHTRRI - VUČITRN



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri



Kryetari i Komunës

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-04, në bazë të nenit 74 të Ligjit për Zyrarët Publik, nr. 06-L-114 dhe në bazë të nenit 18 të Rregullores nr.11/2020 për disiplinën dhe ankesat e zyrtarëve publik, kryetari i komunës, merr:

V E N D I M


Për emërimin e komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave në Drejtorinë për Arsim.

I. Me të cilin vendim emërohet komisioni për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave në sektorin e arsimit të Komunës së Vushtrrisë, në këtë përbërje:

1. Agim Miftari, kryesues i komisionit;
2. Hadika Abdurrahmani, anëtare e komisionit;
3. Jeton Salihu, anëtar i komisionit.

II. Komisioni ka mandat 3 vjeçar.

III. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



REPUBLIKA E KOSOVËS - RITOKU I KOSOVËS
KOMUNA E VUSHTRRI - QYTETI I VUSHTRRI

Numër / Nr. 492/21

No. i fip. / Broj. _____

Data / Datum 27.04.2021

VUSHTRRI - VUCITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 “g” të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet pagesa e faturës numër 21-SHV01-002-50 datë 24.04.2021, në shumë prej 816.00 € (tetqindëgjashhtëmbëdhjetë euro) në llogari të Hotel “Amazona”, Milloshevë, Obiliq, - iftar me Bashkësinë Islame në Vushtri dhe zyrtar komunal.
2. Pagesa e shumës së cekur në pikën paraprake të këtij vendimi të bëhet nga buxheti i Zyrës së Kryetarit të komunës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA E KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRAN	
02 Nr. / Br	493/21
Nr. i fq. / Br. st	
Data: / Datum	27.04.2021
VUSHTRRI - VUČITRAN	




REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 /2008, nenin 5.2 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës me datën 27.04.2021 merr këtë:

V E N D I M

1. Z. Shkelzen Xhaferi, Drejtor për Shërbime Publike në Vushtrri, emërohet anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve nga Komuna e Vushtrrisë në KRM "Uniteti" Sh.A. në Mitrovicë, në vend të Z. Refik Maloku, ish Drejtor i Drejtorisë për shërbime Publike, i liruar nga kjo pozitë me vendimin 02Nr. 78/21, dt. 29.01.2021.
2. Detyrat dhe përgjegjësit e tij do t'i ushtroj në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për Ndërmarrjet Publike dhe aktet tjera me të cilat është e rregulluar kjo çështje.
3. Mandati i tij në Komisionin e Aksionarëve të KRM "Uniteti" Sh.A. në Mitrovicë është i njëjtë me mandatin të cilin e ushtron si Drejtor për Shërbime Publike në Vushtrri.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi i dërgohet:

- Z. Shkelzen Xhaferi
- Arkivit të Sekretarisë